

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"PEAKY HOTEL" SHPK**

Sot më datë 03.09.2022, ne baze te ligjit tregtar themelohet shoqëria si me poshte:

**Ortaku:**

**SKERDI BELLO** , shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Durrës , lindur më 05.11.1990, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal J01105064V

**DENIS KURTI** , shtetas Shqiptar, lindur ne shijak dhe banues në Durrës , lindur më 07.02.1987, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal I70207057J

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008”Per tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe ne ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 për Q.K.R, kërkoi redaktimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqërisë me përgjegjësi te kufizuara si me poshtë vijon:

**NENI I  
EMERTIMI I SHOQERISE**

1.1 Emri i shoqërisë është " **PEAKY HOTEL " SHPK** (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2  
SELIA LIGJORE**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adrese: Durrës, Lagjja nr. 1, Rruga Taulantia, Objekt me nr. Pasurie 26/175+1-N6, Zona Kadastrale 8513

2.2 Asambleja e Përgjithshme mund te vendose mbi transferimin e selisë se Shoqërisë ne një adrese tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë.

**NENI 3  
KOHEZGJATJA**

3.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe te pacaktuar

**NENI 4  
OBJEKTI I SHOQERISE**

4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, duke përfshire por pa u kufizuar ne:

**HOTEL, RESTORANT**

**NENI 5  
KAPITALI I SHOQERISE**

5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabarte me 100.000 leke

5.2 Kapitali i Shoqërisë perbehet nga 2 kuote, si me poshte vijon:

**SKERDI BELLO** , shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Durres , lindur më 05.11.1990, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal J01105064V me 1 kuote qe perben 50% te kapitalit me vleren 50.000 leke

**DENIS KURTI** , shtetas Shqiptar, lindur ne shijak dhe banues në Durres , lindur më 07.02.1987, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal I70207057J me 1 kuote qe perben 50% te kapitalit me vleren 50.000 leke

5.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaket themelues.

5.2 Asnjë nga ortaket nuk mund te transferoje kuoten përkatëse te pjesëmarrjes ne Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim te ortakeve te tjerë. Ne rast se një nga ortaket dëshiron te kaloje/transferoje plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij ne Shoqëri, duhet t'ia ofroje ketë kuote për blerje ortakeve te Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) diteve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortaket do te kenë te drejtën te blejnë kuotën e ofruar ne shitje sipas çmimit dhe mënyrave te pagesës për te cilat kane rene dakord me ortakun shitës.

5.3 Ne rast zmadhimi apo zvogëlimi te kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortaket do te kenë te drejtën e nënshkrimit te zmadhimit apo zvogëlimit te kapitalit ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen qe zotëron secili ne kapitalin e Shoqërisë.

## **NENI6**

### **KALIMI I KUOTES ME TRASHEGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT**

6.1 Ne rast vdekje apo falimentimi te njërit prej ortakeve, kalimi i kuotës dhe i te drejtave përkatëse ne favor te trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet te shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit te ortakut. Ne rast refuzimi te pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit te sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguaje trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta vlerën e kuotës qe do te përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore te Shoqërisë dhe vlerën e tregut te kuotës.

6.2 Personi qe fiton te drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortakut mund te zgjedhe te behet zotërues i kuotës ose te kërkoje regjistrimin e kuotës ne emër te një personi tjetër te zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh te behet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë ne lidhje me këtë vendim.

- 6.3 Personi qe fiton te drejtat mbi një kuote për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku do te këtë te drejtat qe gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar te drejtën e pjesëmarrjes ose te votës ne çdo mbledhje te Asamblesë se Përgjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit si zotërues i kuotes.

## NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve qe janë thirrur por nuk ishin te pranishëm ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme qe vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kenë te drejtën te nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne përpjesëtim te drejte me kuotat qe zotërojnë ne Shoqëri.
- 7.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nënshkrimit te pjesës se tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund te nënshkruhet nga ortaket e tjerë. Ne këtë rast, këta ortake mund te ushtrojnë serish te drejtën për nënshkrimin e kapitalit, ne përpjesëtim te drejte me kuotat e pjesëmarrjes ne Shoqëri.


## NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zvogëloje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund te zvogëlohet nen kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortaket e përballojnë zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

## NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi te gjitha çështjet për te cilat është kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakeve te Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme, te shprehe vullnetin e tij si dhe te votoje ne përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zotëron ne Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokure me shkrim.
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshire telekonferencën (conference call) audio ose video, ne përputhje me ligjin për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet

3



elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratoret ose nga ortakët në baze të nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara. Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.
- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratoret. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.
- 9.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të perfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon neni 9.10 i këtij Akti Themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zoterojnë me shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të të paktën 51 % të ortakëve pjesëmarrës ( shumica e kualifikuar) në baze të nenit 87 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare", për ndryshimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.


#### NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/et i cili/te cilët për një periudhë prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori/et mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 2 administrator:

**SKERDI BELLO**, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, lindur më 05.11.1990, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal J001105064V

**Ortaku:**

**DENIS KURTI**, shtetas Shqiptar, lindur në Shijak dhe banues në Durrës, lindur më 07.02.1987, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nr. personal I70207057J



- 10.2 Administratori/t zotëron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme për realizimin e objektit te Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e te cilëve i rezervohet Asamblesë se Përgjithshme apo organeve te tjera te Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjate administrimit te Shoqërisë dhe mund te autorizojë persona te trete, për te përmbushur veprime te caktuara, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë. Ne çdo rast, administratori do te jete përgjegjës për veprimet e te tretëve te autorizuar.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratoreve te shoqërisë.
- 10.4 Administratoret nuk do te mund te marrin hua nga Shoqëria ose te lëshojnë garanci, dorëzani, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë, për hua dhe financime te dhëna nga te tretet.
- 10.5 Administratoret do te veprojnë ne çdo kohe vetëm ne interesin me te mire te Shoqërisë. Ne rast konflikti interesi, Administratori do te njoftojë menjëherë ortaket si dhe do te heqë dore nga çdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

#### **NENI 11 VITI FINANCIAR**

11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

#### **NENI 12 KONTROLI FINANCIAR**

12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël te Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emërojë një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne atë raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet ne baze te ligjit.


#### **NENI 13 BILANCI VJETOR**

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe te Ekspertit Kontabël te Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e përgjithshme .
- 13.2 Dokumentet qe kane te bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

#### **NENI 14 DIVIDENDET**

14.1 Ne përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve ne baze te rezultatit financiar te shoqërisë.

#### **NENI 15 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**



- 15.1 Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakeve, administratoreve, likuiduesit, do t'i nënshtrohen juridiksionit te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane.

**NENI16**

**GJUHA**

- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet ne 4 (katër) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

**NENI17**

**DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

- 17.1 Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Për sa nuk parashikohet ne këtë Akt Themelimi dhe Statut, do te zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

**ORTAKU I SHOQERISE**

Shëroki Bello  
Bello

Denis Kurti  
Denis